

Përshëndetje,

Në përgjigje të kërkesës suaj për informim të datës 21.08.2025, Departamenti i Administratës Publike (DAP) ju informon si më poshtë vijon:

DAP ushtron funksionin e tij në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij. Bazuar në gërmën “F”, të nenit 4, të ligjit të sipërcituar, DAP është “njësi përgjegjëse” për institucionet e administratës shtetërore, ndërsa për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore “njësi përgjegjëse” është njësia e burimeve njerëzore. Referuar përcaktimeve të po këtij neni, “institucion i administratës shtetërore” konsiderohet aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit.

Instituti i pezullimit nga shërbimi civil parashikohet në nenet 53-57, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ndërsa rregullimi i tij në mënyrë më të detajuar bëhet përmes VKM-së nr. 124, datë 17.2.2016, “Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, të ndryshuar.

Referuar neneve 54 dhe 55, të ligjit nr.152/2013, të ndryshuar dhe kreut I, të VKM-së nr. 124, date 17.02.2016, i ndryshuar, konstatimi dhe miratimi i pezullimit bëhet nga njësia e burimeve njerëzore e institucionit, dhe DAP-it për TND. Për institucionet e administratës shtetërore, njësia e burimeve njerëzore njofton njësinë përgjegjëse për pezullimin e nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët apo të mesme drejtuese, brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e konstatimit apo miratimit të pezullimit.

Referuar pyetjes së parë:” *Kërkojmë të informohemi sa është numri i kërkesave të pezullimit të statusit të nëpunësit civil, gjatë viteve 2021, 2023 dhe 2025?*”, nga të dhënat e administruara rezultojnë se:

1. Për vitin 2021, janë pezulluar 149 nëpunës civilë;
2. Për vitin 2023 janë pezulluar 226 nëpunës civilë;
3. Për vitin 2025 (deri tani) janë pezulluar 95 nëpunës civilë;

Referuar pyetjes së dytë dhe të tretë:” *Për çfarë shkaqesh kryesisht kanë kërkuar "pezullim të statusit të nëpunësit civil?"*”, “Cilat kanë qenë afatet kohore të pezullimit të "statusit" të këtyre individëve?”, bëjmë me dije se nëpunësit civil janë pezulluar:

1.Me kërkesë të vetë nëpunësit, për arsyet dhe afatet kohore të parashikuara në nenin 55, të ligjit 152/2013, i ndryshuar, dhe pikat 10 dhe 12, të kreut I, të VKMsë nr. 124, datë 17.2.2016, “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, të ndryshuar. Më konkretisht arsyet janë:

1. Për arsye shëndetësore të tij apo të njerëzve të afërm të tij (për një periudhë deri në 2 vjet);
2. Për periudha studimi (për një periudhë deri në 2 vjet);
3. Për punësim në aktivitet privat (për një periudhë deri në 2 vjet);
4. Kur zhvillon veprimtari në kuadër të organizatave apo institucioneve ndërkombëtare (për periudhën përkatëse);
5. Për punësim në një institucion nuk është pjesë e fushës së veprimit të legjislacionit të nëpunësit civil (për një periudhë deri në 2 vjet).

2.Për shkak të ligjit, për arsyet dhe afatet kohore të parashikuara në nenin 54, të ligjit 152/2013, i ndryshuar. Më konkretisht arsyet janë:

1. Për shkak të emërimit në një nga funksionet e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “gj” të nenit 2 të këtij ligji (për periudhën përkatëse të emërimit);
2. Janë regjistruar sipas ligjit, si kandidat për zgjedhjet vendore apo politike (për periudhën nga regjistrimi deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar apo deri në përfundim të mandatit);
3. Kur gjykata vendos ndaj nëpunësit civil si masë ndaluese pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik, sipas ligjit në fuqi;

Vlerësojmë t’ju informojmë se, sipas përcaktimeve të neneve 53 dhe 56, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, dhe kreut II, të VKM-së nr. 124, datë 17.2.2016, i ndryshuar, gjatë periudhës së pezullimit, marrëdhënia e shërbimit civil nuk mund të përfundojë dhe nuk mund të ndryshojë, përveçse me nismën e nëpunësit të pezulluar ose kur parashikohet shprehimisht nga ky ligj.

Nëpunësit civil të pezulluar, në përfundim të periudhës së pezullimit, me rënien e shkakut të pezullimit, apo edhe më herët njoftojnë njësinë përgjegjëse për përfundimin e pezullimit dhe rikthimin në shërbimin civil. Në vijim të procedurës së mësipërme, njësia përgjegjëse e institucionit përkatës rikthen nëpunësin civil në pozicionin e mëparshëm të punës ose në rast se pozicioni i mëparshëm është i plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një vend tjetër të së njëjtës kategori. Në rast se kjo është e pamundur, nëpunësi regjistrohen në një listë, deri në sistemimin në një pozicion të rregullt në shërbimin civil. Gjithashtu, gjatë kohës së qëndrimit në listë, nëpunësi e ruan statusin e nëpunësit civil dhe mund të konkurrojë për lëvizje paralele ose ngritje në detyrë, brenda shërbimit civil.

Referuar pyetjes së katërt: *"A janë rikthyer përsëri në shërbimin civil me të njëjtin status këta individë?"*, nga të dhënat që administrojmë rezulton se kanë kërkuar përfundimin e pezullimit dhe janë rikthyer në shërbimin civil:

1. Për vitin 2021, 57 nëpunës civilë;
2. Për vitin 2023, 63 nëpunës civilë;
3. Për vitin 2025, (deri më tani) janë rikthyer 23 nëpunës civilë